

Rekomandime për kultivim Ushqim dhe kullotë e përhershme



1. Rekomandime për mbjelljet

Përgatitja e shtratit të farës

Farërat e imta të loliumeve dhe tërfilit kërkojnë një shtrat të shkrifët dhe **te ceket me një thellësi prej 0,5 – 1 cm**, mbulimi duhet të jetë i mirë. Farërat e barit janë fara që duan dritë, kjo do të thotë që ato nuk duhen mbjellë thellë: **maksimalisht 0,5 cm thellë**. Për forcimin e shtratit të farës duhet që sipërfaqja e tokës të nivelohet pas mbjelljes së re. (psh. cilindri Cambridi) kështu bëhet dhe mbulimi i sipërfaqes së mbjellë i cili shmang në një farë mase rrezikun e ndotjes së mases se korre në kosen e pare .

Koha e mbjelljes

Mbjelljet e pranverës: në tokë të ngrohtë dhe të punuar mirë. **Të mos mbillen shumë herët por të pritët që te perfundojnë ngricat.**

Përparësia është: lagështia e dimrit dhe reshjet e shpeshta gjatë muajve prill dhe maj shfytëzohen mirë. Në zona të thata duhet shfrytëzuar pranvera.

Mbjelljet e verës

Sa më shpejt që të jetë e mundur pas të korrave kryesore. Kur fara është e përzier me tërfil, atëherë mbjelljet duhen bërë **jo më vonë se mezi I gushtit**, kurse të gjitha mbjelljet e tjera duhen bërë **deri në fund të gushtit**. Duhet patur parasysh gjëndja e tokës.

Sasia e farës

Duhet ruajtur sasia e caktuar për hektar, në të kundërt llojet që rriten më shpejt shtypin ato që rriten më ngadalë.

Në rastet kur toka ose klima nuk janë të favorshme mund të përdorim një sasi më të madhe fare. Për të ruajtur sasinë e duhur të farës bëjmë provën e mbirjes

Kulturat shoqeruese mund të perdoren vetëm për sipërfaqet e pjerrta (rreziku i erozionit) ose tek sipërfaqet që janë shumë të ndjeshme ndaj thatësisës (rreziku i tharjes së të mbjellave të reja) mund të mbillet elb vere ose tërshërë (60 – 80 kg/ha). Këto kultura shoqeruese duhen pastruar në kohën e duhur me qëllim që të mos pengohet rritja e të mbjellave.

Në fazën e parë të rritjes prania e barërave të këqia është e madhe. Toka e hapur (e punuar) favorizon rritjen e tyre. Në periudhën kur të mbjellat kanë arritur lartësinë 10 – 15 cm është i këshillueshëm një pastrim i cili do të reduktonte këto barëra dhe kështu do të kishim kushte optimale për rritjen e mbjelljeve të reja.

Karakteristikat e tokës

Vlera e pehashit për livadhet duhet të jetë midis 5,0 dhe 6,5 (shiko tabelën) – përpara se të bëhet hedhja e gëlqeres duhet bërë testimi i tokës. Kur **vlera e PH** shkon **mbi 7,0** ushqimi i bimëve përkeqësohet dhe kjo ngadalëson rritjen e kulturave bujqësore.

Leguminozet kërkojnë kalcium; për një rritje optimale dhe një lidhje biologjike të mirë të azotit, duhet të sigurohet një furnizim i mjaftueshëm me Kalcium dhe **vlera e PH** duhet të jetë **mbi 5,0**, në rastin e jonxhës **tek 6,5 – 7**.

Vlera e PH-shit që synon në CaCl₂ në varësi të peshës së tokës dhe drejtimit të shfrytëzimit (BMFL, 1999)

Lloji i tokës	Tokë, pemishte dhe vreshta	livadhe
E lehtë	Rreth 5,5	Rreth 5,5
mesatare	Rreth 6,5	Rreth 5,5
E rëndë	Rreth 7,0	Rreth 6,0

Potenciali i farës së lëpjetës në tokë

Potenciali i farës së lëpjetës në tokë është fare i qarte – në tokë gjenden fara të lëpjetave që janë mbledhur në vitet paraardhës. Lëpjeta gjen kushte optimale për embrionin e saj në rastet kur bëhet transformim livadhesh. Farat e lëpjetës zënë syth menjëherë sapo bien në sipërfaqe, sepse ato janë embrione që kerkojnë dritë.

E rëndëshishme: gjatë kultivimit të bëhet kujdes me embrionet – të zhvishet menjëherë lëpjeta! Një lëpjetë e vetme lëshon afërsisht 5000 – 7000 fara në vit – aftësia e së cilave për të lëshuar syth zgjat më shumë se 40 vjet.

Përhapja e farave duhet ndaluar:

- Përdorimi në kohën e duhur të rezervave para se fara e lëpjetës të piqet.
- Të shkulet dhe të pritët lëpjeta gjatë rritjes së parë, të grumbullohen dhe **të largohen nga sipërfaqja e mbjellë**. Kjo vlen p.sh. dhe për stërpujën e livadheve dhe dorëzojën.
- Pas kositjeve të kullotave – të hiqen lëpjetat me qëllim që të mos piqen në tokë.
- Në ato pjesë të tokës du ka mbetje të të korrave dhe atje ku kemi bërë plehërim duhet të pengojmë rritjen e lëpjetës, sepse pikërisht në këto vende ajo përhapet më shumë.

Metoda e mbjelljes

Mbjellje në rrjeshta: vecanërisht e përshtatshme për mot të thatë.

Mbjellje me shperndarje me dore: për toka me lagështi të mjaftueshme, një tokë e tillë favorizon rritjen e bimëve të tilla si tërfil i bardhë ose karabush lëndinash të cilat e bejnë tokën më kompakte dhe më të lehtë për tu punuar.

Ato lloje perzierje farerash të cilat përmbajnë fara me thekë (hala) si p.sh: tëshëra e verdhë, ajo e lëmuar, etj. mbijnë më me vështirësi. Për pajisjet pneumatike të mbjelljes nuk ka vështirësi nëse kemi të bëjmë me rastet e mëposhtëme:

- Rasketa e kutisë së farës hapet plotësisht.
- Kutia e farës mbushet deri në gjysëm, boshti rrotullues duhet të jetë gjithmonë i mbuluar.
- Shpejtësia reduktohet në 5 – 6 km në orë.
- Shpejtësi më të vogël të boshtit rrotullues që sjell farën.

Plehërimi

Që plehërimi të bëhet ashtu sic duhet duhet patur parasysh rradha dhe rregullat e cakturara.

Plehu organik është burimi kryesor për ushqimin e tokës dhe të bimëve me substanca organike, me subsancat kryesore ushqyese dhe me bioelementë - azoti mineral duhet të përdoret për cdo rast. Pra vlerësimi, depozitimi, trajtimi dhe përdorimi i plehut organik merr një rëndësi thelbësore. Testimi i tokës (cdo 4 ose 5 vjet) ka si qëllim vlerësimin e substancave ushqyese të tokës dhe hartimin e planit për plehërimin e saj.

Në vitin e mbjelljes së leguminozeve livadhet nuk duhet të jenë të plehëruar. Plehu organik, mbeturinat ushqimore ose plehu organik i lëngshëm mund të shpërndahen në varësi të sasisë dhe nevojave të leguminozeve.

Plehu organik i marrë nga stalla

Duhet të shpërndahet në sasi të vogla 10 – 15 t pra m³ / ha. Kështu rreziku i barërave të këqija dhe i ndotjeve bëhet më i vogël dhe toka mund të punohet më lehtë.

Plehërimi kimik

Në rastet kur pleherimi organik nuk mund të mbulojë nevojën për azot atëherë mund të shpërndahet pleh azotik. Sipërfaqet e pasura me bar kanë nevojë për 50 kg azot për ha për cdo rritje (kombinimi: azoti i tokës, ai i plehut organik dhe i plehut kimik). Në livadhe dhe kullota (në sipërfaqe të mbuluara me bar) sidomos gjatë periudhave të thatësirës kur nevoja e bimëve për ushqim është e madhe, shpërndarja e plehut azotik është shumë efiçente. Sasite në rritje të azotit cojnë në mënjanimin e leguminozës në fushë – fiksimi biologjik i azotit zvogëlohet. Në qendrueshmerine e bimeve foragjere plehu organik është i rëndësishëm.

Kripa e potasit (K_2O) dhe fosfati (P_2O_5): për një tokë e shkruar 10 – 15 mg/100g është e mjaftueshme – të merret parasysh testimi i tokës! Në po të njëjtën tokë sasia e magnisit duhet të jetë midis 5 mg dhe 10 mg. (të merret parasysh testimi i tokës). Para së gjithash është e rëndësishme që tërësi të rritet mirë. Plehërimi organik duhet bërë patjetër në kohën e vegjetimit (mbirjes) dhe duhet bërë vetëm në:

- Në sipërfaqet ku mund të punojnë marinerite bujqësore
- Në temperatura të ulta (mbrëmjeve)
- Në mot më shi të imët dhe pa erë
- Pas mbarimit të suksesshem të të korrave (mbaron magazinimi –fillon pleherimi)

Në fund të kohës së vegjetimit bimët marrin më pak lëndë ushqyese, - kështu mund të ndodhë precipitimi i tyre në shtresa më të thella të tokës, ku vecanërisht barërat e këqija përfitojnë nga këto lëndë ushqyese – si p. sh. Lëpjeta me rrënjët e saj të thella.

Shfrytëzimi

Foragjeret e gjelberta, përgatitja e silazhit dhe barit të thatë


Në fazën e vegjetimit ``kercejte ose filizat`` e barit, vecanërisht në rritjen e parë, japin ushqim voluminoz cilësor dhe ruajnë gjendjen e bimëve dhe përbërjen e tyre. Kur kositet shumë vonë, pengohet rritja e barërave të ulta dhe tërësi të bardhë. Nëse vazhdimisht kositet herët, pengohen barërat e gjatë (p.sh. tershere e lemuar, tërshëre e verdhë dhe timote). Shfrytëzimi duhet të bëhet në harmoni me plehërimin.- rritja e frekuencës së plehërimit kërkon frekuencë më të lartë shfrytëzimi.

Lartësia e prerjes : 5 – 7 cm nëse prerja bëhet me poshtë kjo dobëson aftësinë për të lëshuar sythë, sepse bimëve u merret sipërfaqe asimilimi, dhe forcon ato bimë, të cilat i depozitojnë rezervat e tyre kryesisht nën tokë. Makinerië kositëse dhe mbledhëse duhen rregjistruar mirë, me qëllim që krerthat e barit të mos dëmtohen dhe të shmangen papatërtitë e ushqimit. Dëmtimet e krerthave (stigmave) duhen bërë, për të penguar mbirjen e barërave të këqija si p.sh. tek lëpjeta.

Kullotat

Kur filizat dhe arrijne një gjatësi nga 15-20cm, pjekja e kullotës është arritur. Një drejtim i mirë (p.sh. kullotat me parcela dhe kullotat e gardhuara) dhe një plan i mirë i kullotës i mbajnë sythat të mbrojtur dhe sjellin cilësi në ushqim.

Fazat e shfrytëzimit dhe përmbajtja e energjise tek bimët e livadheve.



Këshilla praktike:

- Bimët asnjëherë nuk duhet të mbeten të pa korrura deri në dimër . gjatësia l deale është nga 7 – 9 cm, bimët më të gjata thahen më lehtë nga dimri (myku l borës etj); kur kemi kultura të përziera me jonxhë gatësia është 10 cm.
- Ushqimi, l korrur në kohën e pjekurisë, ka një tretshmëri prej 70 – 75%, 22- 25% celuloze bruto në masën e thatë, dhe një sasi energjie prej 5,9 – 6,5 MJ NEL/kg masë te thatë. Sasia e këtyre fibrave rritet me kalimin e kohës mbi 30% në masë të thatë

2. Livadhet dhe mbjellja e foragjereve

Llojshmeria - Livadhet e përhershme dhe livadhet e ndryshueshme

Lloji i përzierjes	Emertimi Shkurtimisht sipas ÖAG	Gjendja e të mbjellave	Menyra e shfrytëzimit Si Ushqim :			
			Jeshil	kullotë	silazh	bar i thatë
për administim jo shumë intensiv (deri në tre herë shfrytësim cdo vit)	A	Për zone të thatë	x	(x)	x	x
	B	Për zone mesatare dhe të thatë	x	(x)	x	x
	C	Për zone të lagësht	x	(x)	x	x
	D	Per zone te ashper	x	(x)	x	x
	OG	Për zone të rrezikuar nga kalcinoza pa tërshërë të verdhë	x	(x)	x	x
	VO	Zone mesatare & të lagësht	x	(x)	x	x
Përzierja e livadheve bar cilësor dhe shumë shfrytëzim	G	Zone mesatare & të butë	(x)	x	(x)	(x)
	H	Zone te ashper	(x)	x	(x)	(x)
Përzierja e livadheve per Tre e më shumë vitë shfrytëzimi, adminisrim jo intensiv	WM	Sasi mesatare & të butë	x	(x)	x	x
	WR	Zone te ashper	x	(x)	x	x

Lloji i perzierjes	Emertimi Shkurtimisht sipas ÖAG	Gjendja e të mbjellave	Menyra e shfrytëzimit Te Ushqimit:			
			Jeshil	kullotë	silazh	bar i thatë
Përzierja e farës për kullotat dhe livadhet e përhershëm	NA	Për te gjitha zonat me terfil & pa terfil	X	X	X	X
Përzierja e farës për livadhe intensive(4d he më shumë kosa)rendiment I ushqimit të fushës dhe livadheve	NI	Për te gjitha zonat me terfil & pa terfil	X	X	X	X
Përzierja e farës për livadhe shumë të dëmtuara	NATRO	Ne zone te thate	X	(X)	X	X
Përzierja e farës për livadhe shumë të dëmtuara	NAWEI	Ne zone te thate	X	X	X	X

Lloji i perzierjes	Emertimi Shkurtimisht Sipas ÖAG	Gjendja e të mbjellave	Menyra e shfrytëzimit Te Ushqimit		
			Jeshil	silazh	bar i thatë
Përzierje 1-vjecare (pa kaluar dimrin) përzierje e tërfili 1-verore	EZ	Per te gjitha zonat	X	X	(X)
Bimë 2vjecare(viti I	RE	Per zona pak te lageshta	X	(X)	(X)

mbjelljes&ai i pikut të prodhimit 1dimër) përzjere tërfil I kuq me 1pik prodhimi	RR	Per zona mesatare dhe te ashpra	X	(X)	(X)
Bimë 3vjecare(viti I mbjelljes&2 pike prodhimi 2dimre) përzjere tërfil I kuq 2pike prodhimi	KM	Per zone te bute dhe mesatare	X	X	(X)
	KR	Per zone te ashper	X	X	(X)
Përzjere intensive për ushqim fushe 1-2 vite me pik prodhimi,2-3vite me pik prodhimi	IM	Per zone te bute dhe mesatare	X	X	(X)
	IR	Zona te ashper	X	X	
Bimë3 dhe më shumë vjecare për periudha të gjata; përzjerie jonxhe-tërfili i kuq ;2 e më shumë vite me pik prodhimi	LR	Zone mesatare & të thate	X	X	X
Përzjerie jonxhe për 2 e më shumë vite me pik prodhimi	LG	Zone mesatare & të thate	X	(X)	X